

QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit e aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2024 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 12/24), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2024

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Lëndë e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit me qëllim pastrimin e oxhaqeve për vitin 2024.

1.2. Mjetet financiare për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të bëra për pastrimin e oxhaqeve janë në vlerë neto maksimum deri në 1.200,00 denarë për amvisëri. Tatimi personal mbi të ardhurat është në barrën e Qytetit të Shkupit.

1.3. Në Thirrjen publike për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të amvisërive dhe subjekteve të tjera për pastrimin e oxhaqeve mund të marrin pjesë qytetarë vendbanimi i të cilëve është në territorin e Qytetit të Shkupit (komunat në qytet: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj) të cilët plotësojnë kushtet nga pika 2 e kësaj thirrjeje dhe kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm nga pika 3 nënpika 3.2 e thirrjes.

1.4. Thirrja publike do të zgjasë nga dita e shpalljes duke përfshirë aktivitetet e realizuara për pastrimin e oxhaqeve nga 01.01.2024 deri më 31.10.2024, përkatësisht deri në shfrytëzimin e mjeteve të parashikuara për këtë qëllim në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2024.

1.5. Kërkesat e arritura në Arkivin e Qytetit të Shkupit do të evidentohen me kohën e saktë të depozitimit (data, ora dhe minuta) dhe do të shqyrtohen sipas datës dhe orës së mbërritjes dhe rregullit "i pari që vjen, i pari shërbehet".

1.6. Thirrja publike është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

2. Kритere për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

Aplikuesi për pjesëmarrje në Thirrjen publike është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të jetë banor në territorin e qytetit të Shkupit (komunat në qytet: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj);
- Adresa e pastrimit të realizuar të përputhet me adresën e vendbanimit të kartës së identitetit të aplikuesit;

- Pastrimi i oxhakut të jetë kryer nga profesionist i punësuar në firmë të regjistruar me shifrën e veprimtarisë 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Objekti ku do të pastrohet oxhaku të mos jetë në ndërtimi e sipër;
- Të posedojë kupon fiskal origjinal për kryerjen e pastrimit të oxhakut me datë nga 01.01.2024 deri në shterimin mjeteve të dedikuara për Thirrjen publike, por jo më vonë se 31.10.2024 dhe
- Të posedojë vërtetim origjinal të lëshuar nga oxhakpastruesi për pastrimin e oxhakut me datë nga 01.01.2024 deri në shterimin e mjeteve nga buxheti i dedikuar për Thirrjen Publike, por jo më vonë se data 31.10.2024.

3. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

3.1. Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë qytetarët vendbanimi i të cilëve gjendet në territorin e qytetit të Shkupit: (në komunat: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj), të cilët do të pastrojnë oxhakun e vendbanimit të tyre dhe do të depozitojnë aplikim në Arkivin e Qytetit të Shkupit.

3.2. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhakut aplikuesi nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit detyrimisht duhet të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm në zarf të mbyllur me shënimin: Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor - Komisioni për subvencionimin e amvisërive për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2024:

- Aplikim i plotësuar për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2024 (aplikimi do të shpallet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk;
- Deklaratë e noterizuar se aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për këtë subvencion, se pastrimi është kryer në adresën e kartës së identitetit dhe, se objekti ku do të pastrohet oxhaku nuk është në ndërtim e sipër (ekzemplar i deklaratës do të publikohet në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk;
- Kopje e faqes së përparme të llogarisë së transaksionit (vetëm personale e aplikantit, jo e autorizuar nga një person i tretë), kurse aplikantët që nuk kanë të ardhura të qëndrueshme të jenë regjistruar në Drejtorinë e të Ardhurave Publike me hapjen e profilit të tyre për tatimin mbi të ardhurat personale.
- Faturë fiskale origjinale për kryerjen e pastrimit të oxhakut;
- Vërtetim origjinal nga oxhakpastruesi për kryerjen e pastrimit të oxhakut.

3.3. Vërtetim për kryerjen e pastrimit të oxhakut duhet të lëshohet në emër të aplikantit dhe i njëjti duhet të përputhet me adresën e vendbanimit sipas aplikimit të depozituar:

3.4. Vetëm një person nga amvisëria në vitin në vijim mund të depozitojë vetëm njëherë aplikim për marrjen e subvencionit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve.

4. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

Për të përcaktuar plotësimin e kushteve për ndarjen e mjeteve financiare, kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për subvencionimin e amvisërive për pastrimin e oxhaqeve në vitin 2024.

Pagesa e mjeteve do të bëhet në mënyrë sukcesive sipas renditjes së kërkesave të pranuar, deri në plotësimin e buxhetit të parashikuar për këtë qëllim.

Kur mjetet e planifikuara financiare do të shterojnë, Qyteti i Shkupit do të shpallë përfundimin e Thirrjes Publike.

Për kërkesat që janë të plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kushtet sipas pikës 2 të thirrjes, Komisioni i jep propozim kryetares së Qytetit për ndarjen e mjeteve financiare aplikantëve.

Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, sjell Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare.

Komisioni njofton aplikantët kërkesat e të cilëve janë refuzuar si të paplota, të depozituara jo në afatin e caktuar dhe që nuk plotësojnë kërkesat sipas pikës 2 të thirrjes.